



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive Nr.03/L-048, neni 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës: 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.09.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### Për aprovimin e buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2023-2025

#### Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë MIRATON Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2023-2025. Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2023 është në shumë prej **14,996,357 €**, për vitin 2024 është në shumë prej **15,951,412 €**, për vitin 2025 është në shumë prej **16,564,390 €**.

Burimet e buxhetit janë të hyrat nga grandet qeveritare (granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit, granti specifik i shëndetësisë dhe granti për shërbimet rezidenciale dhe të hyrat vetanake komunale.

#### Neni 2

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2023 totali prej	<b>14,996,357 €</b>
a) Të hyrat nga grandet qeveritare .....	<b>13,943,538 €</b>
b) Të hyrat vetanake komunale .....	<b>1,052,819 €</b>
Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2024 totali prej	<b>15,951,412 €</b>
a) Të hyrat nga grandet qeveritare .....	<b>14,857,751 €</b>
b) Të hyrat vetanake komunale .....	<b>1,093,661 €</b>
Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2025 totali prej	<b>16,564,390 €</b>
a) Të hyrat nga grandet qeveritare .....	<b>15,426,075 €</b>
b) Të hyrat vetanake komunale .....	<b>1,138,315 €</b>

#### Neni 3

Buxheti për vitin 2023-2025 shpërndahet në këto kategori ekonomike :

nr.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga e shitesa	7,609,386	7,647,433	7,685,670
2	Mallra e shërbime	2,432,766	2,526,645	2,610,000
3	Shpenzime komunale	325,000	330,000	340,000
4	Subvencione e transfere	570,000	600,000	600,000
5	Shpenzime kapitale	4,059,205	4,847,334	5,328,720
	<b>Totali</b>	<b>14,996,357</b>	<b>15,951,412</b>	<b>16,564,390</b>

#### Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela e planit të buxhetit 4.1,4.2 dhe 4.3 të sistemit BDMS-së dhe PIP-it, tabela e indikatorëve të performancës dhe tabelat e buxhetimit gjinor.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

#### Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyra së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. Shërbimit të Kuvendit;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

